



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 04.09.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 2-20 shtator 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë". *(Komision përgjegjës)*
4. Shqyrtimi i projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr.134)". *(Komision përgjegjës)*

**Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Klotilda Bushka, , Edlira Bode, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Adelina Rista, Eugen Bojaxhiu, Edmond Stojku, Koçi Tahiri, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ervis Meço dhe Halil Jakimi.

**Mungojnë:**

Ilir Pendavinji, Ardiana Jaku dhe Amra Barova.

**Të ftuar:**

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Astrit Kuka – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ogerta Manastirliu – Ministre e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

Narvina Sinani – Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve  
Mjekësore

Andoneta Njehrrëna – Drejtoreshë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të  
Kadrit Rregullator në Ministrinë e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

Etiola Kola – Këshilltare e Ministres së Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Enver Roshi** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Meqenëse sot është mbledhja e parë e kësaj legjislature, u uroj suksese dhe mbarëvajtje punimeve të komisionit dhe punimeve të Kuvendit!

Në rendin e mbledhjes së parë të këtij komisioni kemi fillimisht miratimin e procesverbaleve.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohe procesverbalet.

Çështja e dytë në rendin e ditës është shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë", për të cilin jemi komision përgjegjës. Të pranishëm kemi zonjën Anila Denaj, ministre e Financave dhe Ekonomisë, dhe zotin Astrit Kuka, përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimit në këtë ministri.

Theksojmë se kjo është një marrëveshje kuadër dhe është në vazhden e marrëveshjeve të mëparshme që ka lidhur vendi ynë me shumë vende, si me Turqinë, Belgjikën, Hungarinë, Maqedoninë, Rumaninë, Republikën Çeke, Luksemburgun, Gjermaninë, Austrinë, vende të tjera, si dhe me Kanadanë, që e kemi sot në tavolinë. Kam dijeni se janë në negociata me Italinë dhe Greqinë dhe presim që edhe këto dy marrëveshje të vijnë shpejt në komision për t'u shqyrtuar, nga e cila do të përfitojë një gamë e madhe njerëzish që punojnë në vendet përkatëse.

Pa dashur të zgjatem, po ia jap fjalën ministres së Financave dhe Ekonomisë, zonjës Anila Denaj.

**Anila Denaj** – Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ju uroj sesion të mbarë!

Faleminderit që na jepni mundësinë për të diskutuar edhe për këto çështje!

Në fakt, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje vjen në vazhden e një procesi të gjatë, që ministria e ka ndjekur prej vitesh, pasi janë procese të cilat marrin kohë. Njëkohësisht, të 12 marrëveshjet, që ju përmendët, kanë marrë kohën e tyre, por besojmë se disa prej tyre, si ajo me Italinë dhe ajo me Greqinë, do të marrin kohë më shumë për shkak të kompleksitetit të ligjeve të ndryshme të dy vendeve, të cilat duhet të përputhen.

Marrëveshja me Kanadanë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në datën 22.04.2015 dhe është nënshkruar në datën 30.04.2019 në Kanada, ku përfaqësues i Shqipërisë ishte ambasadori ynë dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Kanadasë.

Çfarë ka në thelb kjo marrëveshje?! Marrëveshja konsiston në ofrimin e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, në përfitime dhe të ardhura. Gjithashtu, ajo garanton që personat, të cilët lëvizin nga njëri vend në tjetrin, personat në varësi të tyre dhe të mbijetuarit të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar. Bashkimi i periudhave të siguruara, sipas legjislacioneve kombëtare të ndryshme, merret në konsideratë për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, akti i sigurimeve për të moshuar dhe plani kanadez i pensionit në Kanada. Palët kanë rënë dakord të japin përfitime në para për pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje përfitojnë 70 mijë shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë dhe punojnë në Kanada, janë shtetas kanadezë dhe kanë vite të caktuara të punësimit në Shqipëri, sidomos në kompani të ndryshme, në industritë dhe jo vetëm.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, asnjë qytetar nuk do të humbasë asnjë ditë kontributive, pavarësisht se ku ka punuar. Bashkimi i periudhave do të bëjë të mundur plotësimin e kushteve ligjore dhe të krijimin e kushteve më optimale për përfitimin e pensionit kudo që ata jetojnë.

Gjithashtu, pjesë e kësaj marrëveshjeje është edhe eksporti i pensioneve, gjë që do të thotë se pensioni do t'u paguhet qytetarëve shqiptarë në vendin që ato do të zgjedhin qoftë në Shqipëri, qoftë në Kanada. Kështu, shtetasit shqiptarë do të kenë mundësi të marrin pension kanadez, edhe në qoftë se vendosin të jetojnë në Shqipëri.

Së fundi, marrëveshja krijon hapësira ligjore për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë, përveçse në Kanada, edhe në vendet me të cilat Kanadaja ka marrëveshje.

Ky ishte thelbi i marrëveshjes. Jemi të lumtur që kemi arritur në këtë fazë të procesit dhe shpresojmë në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje në parlament. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të fillojë në momentin që do të ratifikohet edhe në parlamentin kanadez. Kështu që koha do të jetë e përputhur në të dyja aspektet ligjore të të dyja vendeve tona.

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Faleminderit juve!

Vijojmë me pyetjet nga kolegët e komisionit. Kush e do fjalën?

Kjo është një marrëveshje, besoj e ratifikuar, ndërmjet të dyja qeverive, ndaj komentet janë të pakta.

Unë kam një pyetje për sqarim: çfarë nënkuptohet me bashkimin e periudhave?

**Astrit Kuka** – Bashkimi i periudhave të sigurimit do të thotë që vitet e punës të siguruara në Shqipëri do të bashkohen me vitet e punës të siguruara në Kanada për të llogaritur pensionin.

Për ta thjeshtësuar, nëse në Shqipëri duhen 15 vjet punë për të marrë një pension, nëse ka më pak se 15 vjet nuk e përfiton. Ky është edhe standard i komunitetit europian. Një personi që ka disa vite në Kanada, supozojmë se ka edhe dhjetë vjet në Shqipëri, i bashkohen këto periudha dhe ai bëhet i përshtatshëm për aplikim në vendin tonë, sepse i plotëson 15 vjet në të dyja vendet dhe merr pension në Shqipëri, njëkohësisht edhe Kanadaja, nëse e kalon cakun minimal prej 10 vjetësh që ka Kanadaja për të dhënë përfitimin. Kështu që në rastin tonë përfitimi është i dyfishtë. Pra, personat që kanë kontribuar përfitojnë edhe në Shqipëri, edhe në Kanada, ku përfitimi është shumë i madh. Në Kanada përfitimi është më i lartë se në vendet e tjera, jo vetëm se kemi 70 mijë vetë, por edhe për faktin se Kanadaja, duke pasur një sistem të sigurimit shoqëror edhe rezidencial, edhe me kontribute, vetë qëndrimi në Kanada më shumë se 10 vjet të jep një përfitim, por që merret vetëm në Kanada. Nëse kalojnë 20 vjet ai përfitim mund të merret kudo në botë dhe shqiptarët këtë kërkojnë, sepse bëjnë mbi 10 vjet në Kanada, marrin një përfitim atje, por në momentin që vijnë në Shqipëri u hiqet ai përfitim, ndërsa duke parashikuar periudhën 12 vjet në Kanada dhe 15 vjet në Shqipëri kalon afatin 20-vjeçar dhe atë përfitim që marrin në Kanada mund ta marrin në Shqipëri. Kjo është mirëpritur dhe ka pasur shtysë nga emigrantët atje. Procedurat janë vonuar jo nga pala shqiptare, sepse i kemi pasur gati që në vitin 2015, por edhe ato kanë pasur problemet e veta, sepse është një kosto e madhe për shtetin e tyre. Tani çdo gjë është nënshkruar, pritet ratifikimi për të filluar zbatimin.

**Enver Roshi** – Një pyetje tjetër e rëndësishme është se në çfarë faze janë bisedimet lidhur me përfitimet nga shtetasit që jetojnë në Itali dhe Greqi.

**Anila Denaj** – Lidhur me afatet është zoti Kuka, i cili do t'ju sqarojë për këtë, sepse eksperiencia e tij në këtë proces është e padiskutueshme. Më lejoni t'ju them që këto janë procese që marrin kohë dhe, e theksoj edhe një herë, që nuk janë vetëm për çështje që lidhen me proceset e organizmit tonë të brendshëm, sepse ne kemi fituar një eksperiencë, pasi kemi 12 marrëveshje dhe e dimë shumë mirë se si e fillojmë mbarë një proces, por janë shumë akte ligjore që duhet të përshtaten dhe, mbi të gjitha, duke e menduar numrin e madh të emigrantëve që janë në dy vendet që ju përmendet, sigurisht kjo ka një kosto për buxhetin e vendeve dhe

nuk duhet të harrojmë që duhet të shikojnë nëse këtë praktikë e kanë edhe me vende të tjera pritëse emigrante në vendin bazë. Detyrimisht kjo na çon në disa negociime pak më të vështira në aspektin kohor, edhe pse vullneti nga pala italiane ka ecur dhe jemi në avancime më të mëdha se me palën greke. Megjithatë, nuk mund të shprehemi për afate strikte, por nga eksperiencia e mëparshme mund të themi që kjo do të marrë një periudhë më të gjatë kohe sesa ajo e Kanadasë. Ndoshta zoti Kuka mund t'ju jap një shpjegim teknik.

**Astrit Kuka** –Dua të shtoj diçka lidhur me përpjekjet konkrete që kanë bërë institucionet. Ka një proces të ndarë, ka përpjekje që kanë bërë institucionet për të shkëmbyer eksperiencë dhe informacion për të ndihmuar shtetin shqiptar dhe një tjetër që lidhet drejtpërdrejt me marrëveshjen ndërqeveritare, e cila ka disa probleme të mëdha, që i përmendi zonja ministre. Që nga viti 1999 janë bërë disa marrëveshje me institucionet italiane, që merren me trajtimin e pensionisteve dhe është arritur në konkluzionin që të paktën... Janë lehtësuar shumë procedurat për të përfutur pension në Itali, por edhe për shqiptarët që janë në Itali. Madje, strukturat italiane kanë ngritur një strukturë të veçantë në Shqipëri, që merret posaçërisht me mbledhjen e periudhës së sigurimit për shtetasit shqiptarë, të cilët nuk kanë mundësi të vijnë në Shqipëri për të mbledhur këto periudha sigurimi. Ata bashkëpunojnë me institutin dhe u përgatitin dosjen personave që janë në Itali.

Me gjithë kërkesat që janë paraqitur disa herë dhe me të gjitha projekte që janë paraqitur nga ana jonë, ambasada italiane në bashkëpunim me ministrinë është angazhuar disa herë, por shtytje të veçantë ka marrë në vitet 2013-2014, pasi në vizitën e tij, Kryeministrit Renci, i premtoi Kryeministrit tonë për një marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore. Ne ishim të gatshëm dhe ekipi negociator shkoi në Itali me projekt të gatshëm me studime analitike, që ishin bërë për këtë periudhë, por hasin pengesa të mëdha në punë, sepse bëhet fjalë për një numër të madh. Vijnë shqiptarët edhe nga vende të tjera, të jemi të sigurtë, pavarësisht se ambasada amerikane e ka kundërshtuar këtë teori, të cilët, natyrisht, e kërkojnë. Pra, kemi vendet e rajonit dhe të Mesdheut, si Italinë, e cila zë vendin e parë për emigrantë, ku, natyrisht, edhe ata e kanë kërkuar para nesh. Ngarkesa për Italinë bëhet shumë e madhe. Ne kemi 500 mijë veta, por kemi një avantazh shumë të madh, që ata e kanë vlerësuar për dy arsye: ne kemi 240 mijë veta që punojnë dhe japin kontribute në Itali në fushën e sigurimeve shoqërore. Pra, është një ingranim shumë i madh i shtetasve shqiptarë në Itali. Janë 128 mijë nxënës dhe studentë, pra pothuajse të gjithë shqiptarët që janë të angazhuar.

Së dyti, nga pikëpamja e strukturës moshore: struktura moshore në Itali është favorizuese për ne, sepse rreth 28 mijë veta për 10 vjetët e para i bie të përfitojnë nga skema e

sigurimeve shoqërore, në qoftë se bashkohen periudhat, sepse të tjerët janë të rinj dhe përfitojnë shumë vonë, madje ata përfitojnë nga vetë sistemi italian.

Nga ana tjetër, nga kostoja që kanë përballuar italianët, e vërteta është se 60 mijë pensione i japin për personat mbi moshë, që i quajnë asistencë sociale, por, faktikisht, 450 euro për ne janë shumë, por nuk kanë dhënë një afat konkret të prerë. Pra, asnjëherë nuk kanë thënë që nuk vazhdon, por asnjëherë nuk ka dhënë ndonjë ritëm. Për shembull, nuk iu përgjigjën thirrjes sonë për të ardhur për të filluar negociatat në Shqipëri, sepse jemi dakord që të presim kohën e nevojshme, por edhe ndryshimet e qeverive atje bëjnë punën e tyre. Gjithsesi, është një proces që nuk ndalon.

Për shembull, edhe me Greqinë ka 5-6 vjet që konsiderohet i stopuar si proces, sepse ministri i Jashtëm ka bërë disa herë kërkesa, edhe personalisht, edhe me shkresa zyrtare, por edhe ne kemi dërguar projekte. Ata kanë si problemin më të madh efektin financiar të skemës, sepse skema e tyre është pak më e brishtë.

Natyrisht, Ministria e Jashtme bashkë me ministrinë tonë janë në vazhdimësi të kësaj pune, por dhe Ministria e Diasporës ka një program të veçantë për këtë punë.

**Anila Denaj** – Sigurisht, ne do të vazhdojmë përpjekjet tona, duke rikujtuar herë pas here fazat e negociatave midis dy palëve, por, sikurse tha edhe kolegu im, janë procese, të cilat nuk varen vetëm nga pala shqiptare. Kjo nuk na pengon aspak që, pas një marrëveshjeje si kjo e Kanadasë, të sjellim edhe në vëmendje të marrëveshjes me italianët që të vazhdojë procesi, pasi çdo eksperiencë sigurisht që shton vlerë edhe në marrëveshjen e negociimit.

**Enver Roshi** – Urdhëroni, zonja Bode!

**Edlira Bode** – Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, zoti Kuka, për prezantimin që na bëtë për finalizimin e kësaj marrëveshjeje shumë të rëndësishme, pra marrëveshjes me Kanadanë, përtej informacionit që na dhatë edhe për dy vendet e tjera!

Kam vetëm një pyetje të shkurtër: a ka një studim? A keni statistika se sa shtetas kanadezë jetojnë në Shqipëri?

Çfarë efekti ka kjo marrëveshje te buxheti shqiptar? A keni informacion për këtë?

Faleminderit!

**Anila Denaj** – Llogaritjet në raport me buxhetin janë pjesë e fondeve të skemave, të cilat Instituti i Sigurimeve Shoqërore i ka të menaxhueshme dhe nuk janë fonde shtesë, të cilat do të dalin nga buxheti i shtetit për këtë proces. Kjo është e garantuar. Se sa kanadezë janë në Shqipëri dhe në çfarë industrie, ndoshta zoti Kuka e thekson.

**Astrit Kuka** – Në fakt, për numrin e kanadezëve në Shqipëri ne nuk kemi një informacion të saktë. Ne kemi informacion për numrin e atyre që kanë marrë leje qëndrimi, por lejet e qëndrimit kanë qenë edhe të përkohshme dhe nuk është se janë vendosur përherë në Shqipëri apo kanë kontribuar. Nga Ministria e Brendshme këtë burim kemi pasur, pra kemi sa shtetas kanadezë kanë marrë leje qëndrimi, por kanë qenë pak dhe shumica e tyre kanë ikur, sepse kanë qenë të lidhur me industrinë e naftës.

Natyrisht, ne do t'u kërkojmë atyre një informacion, mbase ata do të na përgjigjen. Nuk diskutohet që janë shumë më pak, nuk bëhen as 100 veta, kurse ne kemi 70 mijë veta.

Së dyti, kryesorja është se pala kanadeze, me thënë të drejtën, jo për ndihmë të Shqipërisë, por vetë sistemin e ka shumë gjeneroz. Nga kjo përfitojnë shqiptarët dhe shumë vende të tjera. Ka një skemë shumë të qëndrueshme, skema e tyre ka një fond rezervë sikur për 4 vjet të mos mbledhet asnjë kontribut. Janë 33 milionë kontribues në skemën e tyre të pensioneve, ato kanë ngritur çështje të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sesa çështje të skemave financiare, siç kemi ne probleme të këtij niveli. Për të qenë konkretë në lidhje me pyetjen ne do të interesohemi, që t'ju informojmë aq sa kemi mundësi për të marrë informacion nga pala.

**Enver Roshi** - Kam një pyetje të fundit, para se ta mbyllim. A keni regjistër për të gjithë emigrantët që janë në Komunitetin Europian ? Ju thatë se në Kanada janë 70 mijë, në Itali janë 280 mijë. 500 punojnë në Greqi.

**Astrit Kuka** - Regjistër të saktë nuk ka. Qeveria është angazhuar me një program për të filluar një regjistrim të përgjithshëm të të gjithë emigrantëve. Problemi ndryshon pak, se këtu të dhënat janë kamufluese, nëse sot janë 70 mijë, nesër do të vijnë edhe të tjerë, sepse marrëveshja mbetet 100- 200 vjet pa ndryshuar dhe vazhdimisht shtohet numri i atyre që do të jenë përfitues të kësaj skeme. Për shembull, ne kemi që në vitin 1952 marrëveshje me Bullgarinë, duket sikur ka përfunduar efektet, por përditë na vijnë kërkesa nga Bullgaria. Tani do ta rinovojmë dhe muajin tjetër do të fillojmë një marrëveshje të re. Numri nuk lidhet thjesht me personat rezidencialë, ata mund të mos jenë rezidencialë. Kanë qenë 5 vjet në Kanada, kanë ardhur këtu, por do të përfitojnë për periudhën në Kanada, do të përfitojnë për periudhën këtu dhe për periudhën kur kanë qenë në një shtet të tretë me të cilin kemi marrëveshje, supozojmë në Luksemburg, do të marrë edhe të Luksemburgut, të Kanadasë dhe të Shqipërisë, të gjitha do të bashkohen. Tendenca është që në marrëveshjet tona, po arrihet brenda Komunitetit Europian që të mbulohen të gjitha zonat. Një shtetas lëviz nga Greqia shkon në Belgjikë, është e garantuar që e gjithë periudha e Greqisë, ku mund të ketë

punuar për 10 vjet t'i merret në konsideratë. Ne nuk ia marrim drejtpërdrejt, por ia merr Belgjikës, se ka marrëveshje me Greqinë dhe automatikisht po krijohet një rrjet i përgjithshëm. Ne nuk kemi bërë dallim për shtete me shumë emigrantë apo me pak të tillë, sepse edhe sikur transit të kalojë në ndonjë vend, për shembull në Luksenburg, në Çeki e të tjerë, ne e marrim në konsideratë periudhën tjetër si një vend i tretë. Rrjeti është duke u kompletuar. Të jemi të sinqertë ka mangësi shumë në evidentim, sepse edhe lëvizja është dinamike, shpeshherë e pakontrollueshme, por besoj se do të bëhet një vlerësim edhe më rigoroz.

**Enver Roshi** – Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë", sipas tekstit bashkëlidhur? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*

### PROCESVERBAL

Tiranë më 04.09.2019, ora 10:30

#### **Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr.134)". *(Komision përgjegjës)*

#### **Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Klotilda Bushka, Edlira Bode, Adelina Rista, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Edmond Stojku, Koçi Tahiri, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ervis Meço dhe Halil Jakimi.

#### **Mungojnë:**

Ilir Pendavinji, Ardiana Jaku dhe Amra Barova.

#### **Të ftuar:**

Ogerta Manastirliu – Ministre e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

Narvina Sinani – Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Andoneta Njehrrëna – Drejtoreshë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

Etiola Kola – Këshilltare e Ministres së Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë

**Enver Roshi** - Meqenëse kuorumi është i mjaftueshëm e deklaroj të hapur mbledhjen e komisionit për shqyrtimin e projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të Konventës (EST nr.134)".

Të pranishme kemi zonjën Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë, zonjën Narvina Sinani, drejtore e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, zonjën Andoneta Njehrrrena, drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe zonjën Etiola Kola, këshilltare e ministres.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

**Ogerta Manastirliu** - Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithë anëtarëve të komisionit!

Ne sot prezantojmë përpara jush një projektligj të rëndësishëm, e konsiderojmë të tillë, pasi është në vijim të punës sonë për procesin e integritetit të Shqipërisë në Europë dhe të përafrimit të legjislacionit përkatës edhe në fushën e shëndetësisë, ku përfshihet edhe fusha e barnave, pajisjeve mjekësore, pra shërbimi farmaceutik. Për t'i hapur rrugë, për ta përafruar sa më shumë legjislacionin kërkohet edhe standardizimi i procedurave, të cilat duhet të jenë të përafruara me ato europiane. Ky projektligj që vjen sot për t'u prezantuar përpara jush dhe do të shkojë në parlament për miratim bën të mundur aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën "Për përpunimin e Farmakopesë Europiane", që është, gjithashtu, edhe një hap për anëtarësimin me të drejta të plota të Shqipërisë në Farmakopenë Europiane.

FE-ja është kuadri rregullator, i cili standardizon dhe garanton kontrollin e cilësisë së barnave në Europë, si dhe monitoron procesin që nga prodhimi deri në tregtimin e barnave.

FE-ja është një dokument ligjor, i cili është i detyrueshëm për vendet anëtare të BE-së dhe përcakton në mënyrë të detajuar standardet më të larta të cilësisë së kontrollit të barnave, si dhe të substancave që përdoren për prodhimin e barnave dhe të të gjithë produkteve farmaceutike përpara se ato të hidhen në treg.

Duke qenë se Shqipëria është në rrugën e anëtarësimit në BE, anëtarësimi në këtë konventë dhe zbatimi i FE-së edhe në Shqipëri do të ishte një përmbushje e detyrimeve që vendi ynë do të ketë në rrugën për hapjen e bisedimeve për këto negociata.

U paraprimë me aderimin në këtë konventë edhe disa ndryshimeve ligjore, që parashikojmë të kemi në ligjin aktual të barnave dhe shërbimit farmaceutik, pasi aderimi në FE na vendos në një standard dhe kur flasim për standard flasim për standard në prodhimin e

barnave, të cilat prodhohen në RSH, por, gjithashtu, edhe standard në kontrollin sasior dhe cilësor të barnave që tregtohen në RSH dhe që importohen nga vendet e tjera.

Pra, garantojmë dy momente të rëndësishme dhe ne të gjithë e dimë se sa shumë rëndësi ka sot për qytetarët cilësia e barnave dhe sa shumë përpjekje janë bërë për ligjin “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, që kuadri të përafrohet me kuadrin europian dhe direktivën europiane “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ndërkohë që standardet duhet të unifikohen.

Pikërisht, aderimi i Shqipërisë në FE garanton që metodologjia e kontrollit që ne dot kemi, qoftë për prodhimin e barnave në vend, qoftë për importin e barnave në RSH, do të jetë tashmë e unifikuar, e standardizuar sipas standardeve të vendosura nga FE-ja. Pra, metodologjia e kontrollit vendos një unifikim dhe përcakton se cilat do të jenë analizat që do të kryhen për substancat nga të cilat prodhohen edhe barnat. Kjo na ndihmon në rrugën drejt përmirësimit të prodhimit vendas, ndërkohë që tregu i prodhimit vendas është ende jo i madh (ka rreth 5 prodhues), por garanton që jo vetëm prodhuesit vendas aktualë të prodhojnë sipas standardeve europiane, duke garantuar cilësinë e barnave që futen në tregun tonë, por edhe u hapim prodhuesve vendas një dritë jeshile që ato prodhime t’i eksportojnë, duke siguruar që barnat që importohen në RSH nga vende europiane apo jo, të certifikohen, të kontrollohen me standardet më të lartë të cilësisë që vendos FE-ja.

Pra, në momentin që nderohemi në këtë konventë, në këtë moment ne kemi pranuar të përdorim të njëjtin standard europian të kontrollit të cilësisë së barnave në RSH.

Ky është një hap për të shtuar sigurinë e barnave, për të kontrolluar cilësinë e tyre dhe për të garantuar qytetarët që barnat që tregtohen dhe barnat që ata përdorin kanë efikasitet maksimal në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, të cilat trajtohen me terapi të ndryshme mjekimi. Në këtë aspekt, ne jemi duke ndërmarrë disa veprime që kërkohen jo vetëm për aderimin në këtë konventë, por edhe për ndryshimet ligjore, të cilat ne parashikojmë t’i propozojmë për të përmirësuar punën tonë në fushën e kontrollit të barnave dhe shërbimit farmaceutik.

Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore proceson një punë voluminoze. Ajo jo vetëm verifikon kontrollin e barnave, realizon regjistrimin e tyre në bazë të standardeve, por edhe analizon serinë e analizave kimike fizike dhe mikrobiologjike për barnat, të cilat regjistrohen e më pas futen në tregun shqiptar.

Testet që zhvillohen në këtë agjenci deri më sot janë të miratuara nga legjislacioni ynë i brendshëm. Me përfshirjen dhe aderimin në këtë farmakope do të vendosim që metodologjinë e përdorur ta kemi të unifikuar me farmakopenë europiane. Për t’i paraprirë këtij aderimi, ne

jemi duke investuar në dy laboratorë të rinj në Agjencinë e Barnave. Pra, në kuadër të investimit që po realizohet, do të ndërtohet një laborator fiziko-kimik dhe një laborator mikrobiologjik, të cilët do të pajisen me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe paralelisht do të trajnohet edhe stafi. Ky investim bëhet për të rritur llojet e analizave që kryhen për barnat, por edhe për të garantuar më shumë siguri dhe cilësi për barnat në tregun e Republikës së Shqipërisë. Këta dy laborator do të bëhen eficientë në muajt e parë të vitit 2020 dhe do të kenë “Biblën” e tyre, që është farmakopeja europiane.

Aderimi në këtë farmakope u hap rrugën edhe disa ndryshimeve ligjore në ligjin aktual të barnave dhe shërbimit farmaceutik. Menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të këtij projektligji, ne do ta sjellim në Kuvend për të diskutuar disa ndryshime, të cilat do të kenë një impakt në cilësinë dhe sigurinë e barnave në treg.

Përveç të tjerave, elementet që përcaktohen në këtë farmakope janë edhe elementet, të cilat janë të pamonitoruara në detaje në tregun farmaceutik. Sot ka shumë prodhues të vegjël farmaceutikë, të cilët bëjnë preparate, për shembull galenike, të cilat janë me flet udhëzuesish dhe substancat e tyre nuk janë të standardizuara sipas standardeve më të mira të prodhimit europian. Ne, sigurisht, që kemi standardet vendase, por, për sa kohë duam dhe aspirojmë të shkojmë në familjen e madhe europiane, patjetër që duhet që t’u paraprimë standardeve, proceseve dhe metodologjive më të mira. Prandaj, me aderimin në këtë konventë bëhemi gati për t’u paraprirë ndryshimeve ligjore dhe, nga ana tjetër, për pasur një kontroll metodologjik cilësor të imtësishëm të të gjitha barnave, duke filluar nga përbërjet galenike, të cilat janë më të thjeshtat dhe deri te barnat, sipas standardeve më të mira të farmakopesë.

Kjo ishte pak a shumë përmbajtja apo thelbi i këtij projektligji dhe i efekteve që ai do të sjellë në tregun farmaceutik.

**Enver Roshi** – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka ndonjë pyetje?

Po, zonja Bode.

**Edlira Bode** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj ministren për prezantimin që na bëri, si dhe e përgëzoj për arritjen e Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Europiane!

Cilësia dhe siguria e barnave gjithmonë kanë qenë një pikë e nxehtë debati dhe diskutimi publik në vendin tonë. Lajmi që ju na dhatë është një lajm i mirë, pasi nga sot e tutje do të kemi të njëjtat standarde me Europën në cilësinë e prodhimit, të tregtimit dhe të përdorimit të barnave.

Unë dua të di nëse me aderimin e Shqipërisë në këtë konventë kontrollojmë e sigurojmë dhe të cilësisë së barnave në Shqipëri do të vazhdojnë ta bëjnë institucionet shqiptare apo ka një mekanizëm kontrolli nga ana e të gjitha vendeve europiane që aderojnë në konventë? Nëse do të konstatohen shkelje të këtyre standardeve, a do të ketë marrje masash në mënyrë që të kemi një garanci për publikun që këto standarde do të respektohen?

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Në ligj thuhet: “Barnat që merren nga vendet e konventës dhe...”. Unë dua të di nëse në këtë konventë përfshihen të gjitha barnat e vendeve që janë anëtare të konventës apo edhe ato që jashtë konventës? A mund të na e sqaroni këtë gjë për ne dhe për gjithë publikun, sepse kjo e disiplinon më së miri tregun farmaceutik, cilësinë e barnave, si dhe cilësinë e trajtimit të të sëmurëve? Unë mendoj se kjo është një ndihmë e madhe që i jepet shërbimit shëndetësor në Shqipëri.

**Ogerta Manastirliu** – Në momentin që ne aderojmë apo adoptojmë standardet në këtë konventë pa dyshim fillojmë të funksionojmë me standardet e konventës. Konventën jodomosdoshmërisht e adaptojmë apo e ratifikojnë të gjitha vendet në botë. Aktualisht në botë janë 100 vende, të cilat e kanë adoptuar këtë konventë dhe ne do të përfshihemi në këto vende, duke u bërë vendi i 101, i cili e adapton këtë konventë dhe fillon të punojë me standardet e tyre. Tregtimi i barnave në Republikën e Shqipërisë, importimi i tyre, bazohet në ligjet e vendit, në ligjin për barnat dhe shërbimin farmaceutik, por standardet që ne do të aplikojmë do të jenë standardet e kësaj konvente.

Kjo do të thotë, për t’i kthyer përgjigje edhe pyetjes që bëri deputetja, që kontrollojmë sa i përket cilësisë së barnave do ta bëjë Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Ne kemi si detyrë të raportojmë në komitetet e kësaj konvente për gjithë punën që bëjmë në raport me zbatimin e standardeve që konventa kërkon. Në momentin që kjo gjë kërkohet, nuk mund të devijohet, sepse është njësoj sikur ti ke shkelur ligji.

Pra, në momentin që vendi ynë aderon në këtë konventë dhe bëhet anëtar me të drejta të plota merr përsipër të përdor të njëjtat standarde dhe metodologji, që nga momenti i prodhimit të barnave në territorin vendas deri në kontrollojmë e barnave që vijnë në territorin e Shqipërisë. Në këtë mënyrë ne standardizojmë për herë parë mënyrën e kontrollit sipas standardeve europiane.

**Enver Roshi** – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

*(Diskutime pa mikrofon)*

E hedhim në votim në parim ligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë me miratimin e ligjit nen për nen.

Neni 1 “Aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën për përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg, 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr. 134)”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Neni 2 “Ky ligj hynë fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

## **MBYLLET MBLEDHJA**